REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports
Ref.Nr. 2003/2018
Data / Datum / Date 18-06-2018
Nënshkrimi / Potpis / Signature
PRISHTINË / PRIŠTINA / PRISHTINA

Republika e Kosovës

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Nr. Protokolli_____
Datë __/__/2018

Nr. Protokolli _____
Datë __/__/2018

PROTOKOLL BASHKËPUNIMI

BAZUAR NË "DEKLARATËN E PËRBASHKËT PËR BASHKËPUNIM DHE PARTNERITET STRATEGJIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS" e DATËS 11 JANAR 2014

I LIDHUR

NDËRMJET MINISTRISË SË KULTURËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Duke iu referuar Protokollit të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, bazuar në "Deklaratën e përbashkët për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës" nënshkruar në Prizren më datë 11 janar 2014, me qëllim themelimin e Kalendarit të Përbashkët Kulturor Vjetor, si dhe bashkërendimin e aktiviteteve kulturore për kalendarin, parashikohet në kapitullin 3 detyrimet e palëve dhe në kapitullin 4 zbatimi i Protokollit të bashkëpunimit.

Protokolli i Bashkëpunimit, në kapitullin 7, parashikon se Palët me marrëveshje mund të plotësojnë dhe ndryshojnë listën e aktiviteteve të përfshira në Kalendarin e Përbashkët Kulturor Vjetor.

Në përputhje me parashikimet e Protokollit të Bashkëpunimit, paragrafin 3 dhe paragrafin 7, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, bien dakord për përfshirjen e aktiviteteve të mëposhtme në Kalendarin e Përbashkët Vjetor për vitin 2018:

Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK)

Qershor - Bashkëpunimin ndërinstitucional midis IMK-së dhe Institutit Kosovar për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM) apo Ministrinë e Kulturës Kosovë, mbi kriteret dhe procedurat për dokumentimit dhe digjitalizimit të Monumenteve kulturore (kartelat e Monumenteve). Gjithashtu shkëmbim eksperiencash në hartimin e akteve nënligjore për mbrojtjen e ndërtimeve dhe zonave të trashëgimisë kulturore.
Maj / qershor - IMK nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim të Evropës Juglindore, do të organizojë Kursin Rajonal "Emergency Response to Cultural Heritage at Risk" ku do të mundësohet pjesëmarrja e specialistëve të interesuar nga Republika e Kosovës (një kuotë e parashikuar).

Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA)

Shtator / tetor - Aktivitet dhe ekspozitë fotografike me titull: "Zhvillimet në territor, një mundësi potenciale për arkeologjinë" - si urë lidhëse ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës".

Muzeu Historik Kombëtar Tiranë (MHK)

Korrik - Ekspozita me titull "Unë jam shqiptar"- ekspozitën ku përfshihen materiale fotografike mbi diasporën shqiptare.

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor

Tetor - këtë vit shfaqja e Operas "Skënderbeu" Prenke Jakova do të shfaqet në për publikun Kosovar.

Galeria Kombëtare e Arteve (GKA)

Shtator / nëntor - Ekspozita e artistes Kosovare Flaka Haliti, ekspozita e parë personale në Shqipëri.
Shtator – Pjesëmarrje e një anëtar të jurisë së bienales Gjon Mili 2018, sipas ftesës së GKK Kosovë.

Teatri

Tetor ***Teatri Kombëtar i Kosovës*** është bashkëpjesëmarrës në Festivalin Mbarëkombëtarë të Teatrit. Tiranë.

Teatri Kombëtar Eksperimental **(TKEKS)**
Shfaqja "Gishti" e autores kosovare Doruntina Basha. Shkurt

Qendra Kombëtare e Fëmijëve dhe Teatri Kukullave **(QKKFTK)**
Shtator – Pjesëmarrje në Festivalin Ndërkombëtare të valleve për Fëmijë "Ylberi i Prishtinës" qyteti i Prishtinës.

Filmi

Qendra Kombëtare e Kinematografisë

Premier Filmi "Fusha e mëllenjave" me regji të Arzana Kraja

Premier Filmi "Cold November" me regji të Ismet Sijarina

Premierë Filmi "Zana" me regji të Antoneta Kastrati

Film në prodhim "Aga" me regji të Lendita Zeqiri

Premierë Filmi "Bashkëprodhim Kosovë-Shqipëri Open Door" me regji të Florenc Papas

Arkivi Qendror Shqiptar i Filmit (AQSHF)

Qershor - Premiera e filmit (pa zë) "Balkan wars" shoqëruar me muzikë live nga artisti kosovar Adorel Haxhiaj.

Libri

"***Java e Bibliotekës***", aktivitet i përvjetshëm i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës.

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë do të jetë edhe këtë vit bashkëpjesëmarrëse në "Javën e Bibliotekës" që zhvillohet në Kosovë.

Mbështetje e hapësirës së përbashkët kulturore

Angazhim për të mbështetur bashkëpunime midis artistëve dhe organizatave të dy vendeve duke vënë në dispozicion një fond special nga fondet e Ministrive respektive që t'i dedikohen aktiviteteve që nxisin bashkëpunime mes dy vendeve.

Ky dokument hyn në fuqi prej datës së nënshkrimit nga palët.

Kujtim GASHI

Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës

Mirela KUMBARO - FURXHI

Ministre e Kulturës e Republikës së Shqipërisë